

AKTI THEMELIMIT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“FLED SHPK”

me seli ne Kucove.

Z. Fredi MARRA, i biri i Alushit, lindur ne Kucove, me 31/01/1968, banues ne Lagjia 1 Maji, Kucove, me zotesi te plote juridike per te vepruar

perpilon

sa me poshte vijon:

1) i lartpermenduri deklaron se themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin shoqeror: “FLED shpk.” me seli ne Lagjia 1 Maji, Kucove,

Ka si objekt te aktivitetit te saj:

1- Zbatimin e punimeve te ndertimit per kategorite:

- Punim dheu, murature, beton e beton-arme, punime shembje, sistemime, taracime, etj.
 - Ndertime civile – industriale, turistike, deri mbi dy kate, kompletimin me instalimet e nevojshme per to.
 - Ndertim rruge, vepra arti, ujesjellesa e kanalizime.
 - Ndertim gez-sjellesa, vaj-sjellesa, etj.
 - Ndertim sillosa, kulla uji betonarme dhe metalike.
 - Punime restaurimi godina civile, veshje fasada, etj.
 - Mirembajtje dhe zhvillim dekori ne mjediset urbane.
 - Punime ne siperfaqet e gjelberta, parqe, pyll.
 - Prodhim materiale inerte, mermer, elemente parafabrikate te paranderura dhe armocementi.
 - Prodhime druri, metalike, plastike e kallepe.
- 2- Prodhim mielli mielli dhe prodhime brumi.
- 3- Grumbullim , perpunim, tregtim i produkteve bujqesore e blegtorale, import – export i prodhimeve te ndryshme.

3) Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i papercaktuar dhe mbi 20 vjet.

4) Kapitali shoqeror eshte leke 100.000 dhe i nenshkruar plotesisht nga ortaku i vetem Fredi Marra.

5) Kapitali shoqeror eshte i perbere nga 100 kuota krejtesisht te paguara, me vlere prej 1.000 leke secila, me numra serie nga 1 deri 100, te mbajtura nga ortaku i vetem.



6) Shoqeria do te administrohet nga administratori i vetem te cilit i jane dhene te gjitha kompetencat e drejtimit te zakonshem e te jashtezakonshem.

Administratori i vetem qendron ne detyre per sa kohe do te funksionoje shoqeria.

Me kete akt, administrator i pare dhe i vetem i shoqerise emerohet Z. Fredi Marra.

7) Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 2001.


8) Vendbanimi fiskal i ortakut te vetem do te jete selia e shoqerise per cdo efekt ligjor.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare me vlere te njejte ligjore.

Shoqeria krijohet dhe do te ushtroje aktivitet ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi, L.n. 7638 del 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" dhe ligje te tjera qe do te jene ne fuqi gjate periudhes se aktivitetit te shoqerise, si dhe ne perputhje me statutin qe konsiderohet pjese perberese e ketij akti dhe qe i bashkengjitet si ANEKSI B

Lexuar, pranuar dhe nenshkruar;

ORTAKU I VETEM


FREDI MARRA

Dhoma e Noterise Tirane


NR 1867 REP 273


VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 25-08-2001 para meje Notere Gentiana Shkodra, ne qytetin e Tiranes, u paraqit:

Fredi Marra, i biri i Alushit, i lindur ne Kucove, me 31.01.1968, banues ne Kucove, me zotesi te plote juridike per te vepruar, personalisht i njohur prej meje

qe me kerkuan vertetimin e nenshkrimeve te tyre ne kete akt themelimi te shoqerise « FLED» shpk. Vertetoj nenshkrimet e tij sipas ligjit.


GENTIANA SHKODRA



STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“FLED” SHPK

me seli ne Kucove.

KREU I

**Emertimi - objekti,
Selia – Afati**

Art.1

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin social “ FLED shpk”.

Art.2

Ka si objekt te aktivitetit te saj:

- 1- Zbatimin e punimeve te ndertimit per kategorite:
 - Punim dheu, murature, beton e beton-arme, punime shembje, sistemime, taracime, etj.
 - Ndertime civile – industriale, turistike, deri mbi dy kate, kompletimin me instalimet e nevojshme per to.
 - Ndertim rruge, vepra arti, ujesjellesa e kanalizime.
 - Ndertim gez-sjellesa, vaj-sjellesa, etj.
 - Ndertim sillosa, kulla uji betonarme dhe metalike.
 - Punime restaurimi godina civile, veshje fasada, etj.
 - Mirembajtje dhe zhvillim dekori ne mjediset urbane.
 - Punime ne siperfaqet e gjelberta, parqe, pyll.
 - Prodhim materiale inerte, mermer, elemente parafabrikate te paranderura dhe armocementi.
 - Prodhime druri, metalike, plastike e kallepe.
- 2- Prodhim mielli mielli dhe prodhime brumi.
- 3- Grumbullim , perpunim, tregtim i produkteve bujqesore e blegtorale, import – export i prodhimeve te ndryshme.

Art.3

Selia e shoqerise eshte ne Kucove, Lagjia 1 Maji. Administratori i vetem ka te drejte te hape seli sekondare, filiale, zyra perfaqesimi dhe agjensi si ne Shqiperi ashtu dhe jashtu saj, madje dhe te transferoje seline e shoqerise, por kjo e fundit gjithesesi do te mbetet ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Art.4

Shoqeria eshte themeluar nga nje ortak i vetem, por ne te ardhmen ajo mund te kete dhe disa ortake.



Vendqendrimi zyrtar i ortakut te vetem, apo ortakeve te tjere, nese keta do te shtohen, ortakeve per cdo raport me shoqerine eshte selia e shoqerise.

Art.5

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i papercaktuar dhe mbi 20 vjet.

Kreu II

Kapitali shoqeror dhe kuotat

Art. 6

Kapitali shoqeror eshte fiksuar ne leke 100.000 (njeqind mije) dhe mund te rritet sipas modaliteteve ligjore.

Art. 7

Kapitali shoqeror eshte i ndare ne kuota qe mund te jene te madhesive te ndryshme, por ne asnje rast me te vogla se Leke 1.000 (njemije) ose shumefish te leke 1.000 (nje mije).

Art.8

Kuotat jane te transferueshme mes te gjalleve me kontrate, mes ortakut dhe bashkeshortit te tij, ose me rruge trashegimie.

Kreu III

Administrimi

Art.9

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem, qe qendron ne detyre sa kohe te funksionojë shoqeria. Z.Fredi Marra eshte administratori i vetem i shoqerise.

Art. 10

Administratori i vetem ka te drejta te cdo lloji, te pakufizuara dhe te lidhura me drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, dhe qe synojne permbushjen dhe realizimin e objektit shoqeror te shoqerise. Administratori eshte organi vendimmarres per shoqerine dhe vendos si per ceshtje te drejtimit operativ, ashtu dhe per probleme te rendesise se vecante, si ndryshime ne kapitalin themelor, statut, etj.

Art.11

Administratori i vetem ka te drejten e firmes perfaqesuese te shoqerise perballe te treteve dhe ne gjykim, me te drejten qe te kryeje veprime, procedura ne shkalle te ndryshme gjyqesore dhe administrative, si dhe te mirekuptohet, keshillohet dhe te arrije ne marreveshje.

Art.12

Administratori i vetem mund te emeroje nje drejtor te ndermarjes apo nje drejtues teknik dhe midis personave jashte shoqerise duke vendosur shperblimet perkatese.

Art.13

Administratori i vetem mund te delegoje pjese te te drejtave dhe kompetencave te tij, perfshire dhe te drejten e perdorimit te firmes se shoqerise nje ose disa perfaqesuesve te vecante, duke i caktuar ketyre kompetencat, funksionet dhe shperblimet perkatese.

Kreu IV



Bilanci dhe te ardhurat

Art.14

Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti dhe viti i pare mbyllet me 31 dhjetor 2001.

Asambleja per aprovimin e bilancit thirret brenda kater muajve nga mbyllje e vitit ushtrimor.

Art. 15

Te ardhurat neto, pasi eshte zbritur shuma prej 5% e destinuar per fondin e zakonshem rezerve, derise kjo kuote te mos kete arritur 1/5 e kapitalit te shoqerise, dhe pasi te jete zbritur shperblimi per drejtorin, do tii kaloje ortakut te vetem.

Kreu V

Shperberja dhe likuidimi

Art.16

Duke pasur te drejte te vendose, ne cdo kohe dhe per cdo shkak shperberjen e shoqerise, administratori percakton modalitetet e likuidimit dhe emerone nje ose disa likuidatore, duke marre ne konsiderate normat detyruese te ligjit.

Kreu VI

Kompetenca gjyqesore

Art.17

Organi gjyqesor i vendit ku eshte vendosur selia e shoqerise eshte organi kompetent per pranimin e te gjitha konflikteve qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, midis shoqerise dhe elementeve peregjithshme te saj dhe ne pergjithesi qe kane te bejne me aktivitetin e shoqerise.

Kreu VII

Dispozita te pergjithshme

Art.18

Cfare nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut, rregullohet ne baze te dispozitave te ligjit shqiptar ne fushen e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar e qe vijne ne perputhje me sa eshte parashikuar ne kete akt.

Art.19

Ky statut eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare me vlere te njejte ligjore. Lexuar, pranuar dhe nenshkruar;

ORTAKU I VETEM

Fredi Marra

FREDI MARRA